

UDHËZIM
Nr. 16, datë 26.6.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 3.3.2023,
“PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË
FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 6 dhe nenit 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar; të nenit 13, të ligjit nr. 36/20022, “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”; të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023” dhe të pikës 5, të VKM-së nr. 125, datë 1.3.2023, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2023”, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 5, datë 3.3.2023, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

1. Në kreun V, “Dokumentacioni që gjenerohet nga regjistrat zyrtarë dhe platforma *e-Albania*”, bëhet ndryshimi si vijon:

a) Në pikën 10, paragrafi i fundit riformulohet si vijon:

“Dokumentacioni që dorëzohet sipas këtij kreu, për masat 1–6, paraqitet brenda datës 31 korrik 2023”.

2. Në kreun VII, “Procedura që do të ndiqet për përzgjedhjen, verifikimin dhe pagesat për masat mbështetëse me nr. 1–6”, bëhet ndryshimi si vijon:

a) Pika 4, riformulohet si vijon:

“Aplikantët, bazuar në listat e shpallura nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, dorëzojnë, brenda datës 31 korrik 2023, dokumentacionin e kërkuar. Dokumentacioni konsiderohet i dorëzuar me depozitimin në Agropikë ose në zyrën qendrore të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, ose i dërguar me postë.”.

3. Në kreun VIII, “Kriteret, aplikimi dhe dokumentet e nevojshme për masat 7 dhe 8”, bëhen shtesat si vijon:

a) Në nënndarjen “i”, kriteret specifike të përfitimit, në shkronjën “a”, në fund shtohet togfjalëshi:

“... ose subjekte posedues sipas kontratave noteriale me pronarin me afat jo më pak se 5 vite nga lidhja e kontratës me Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. Në rastin e posedimit me kontratë, aplikanti duhet të jetë i përcaktuar në lejen e peshkimit”.

b) Në nënndarjen “iii”, dokumentacioni i dorëzuar në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, bëhen shtesat dhe ndryshimet:

- në shkronjën “i”, fjalia e parë riformulohet si vijon:

“i. Për blerjen e pajisjeve dhe punimeve paraqiten 3 oferta origjinale, me afat vlefshmërie jo më pak se 6 muaj nga dita e aplikimit, por në çdo rast me afat vlefshmërie që përfshin datën e lidhjes së kontratës me Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, dhe që përmban:”;

- pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me formulimin si vijon:

“Kur një subjekt shpallet fitues me më shumë se një aplikim, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dhe subjekti lidhin një kontratë për të gjitha aplikimet që financohen”.

4. Në kreun IX, “Procedurat e aplikimit, përzgjedhjes, verifikimit dhe ekzekutimit të pagesave për masat 7 dhe 8”, bëhet shtesa si vijon:

a) Në pikën 6, fjalia e parë, togfjalëshi “30 korrik 2023” zëvendësohet me togfjalëshin “31 gusht 2023”.

5. Në kreun X, “Kriteret, dokumentacioni dhe procedura për masën 9”, në paragrafin “procedura që do të ndiqet për kualifikimin, vlerësimin, përfitimin e mbështetjes me naftë për bujqësinë dhe kontrollin”, bëhet ndryshimi si vijon:

a) pika 14 riformulohet si vijon:

“Shpërndarja e kartave të subjektet përfitues bëhet nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor që mbulon territorin ku ushtron aktivitetin aplikanti fitues. AREB-et dorëzojnë kartat direkt te përfituesit dhe nënshkruajnë procesverbalin ose e dërgojnë me shërbim postar kur procesverbali nënshkruhet nga nëpunësi i shërbimit postar. Në rastin e dërgimit me shërbimin postar nafta tërhiqet pas administrimit të procesverbalit të firmosur.

AREB-et, për çdo subjekt, hedhin në sistemin SMI të naftës për bujqësinë, informacionin për dorëzimin e kartës të subjekti përfitues. Formulari për procesverbalin e dorëzimit të kartës dhe të formës për t’u hedhur në SMI, gjendet në aneksin 10, ndërsa kur dorëzohet nga shërbimi postar sipas aneksit 10/1, bashkëlidhur udhëzimit”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Frida Krifca

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj

ANEKS 10/1

PROCESVERBAL DORËZIMI ME SHËRBIM POSTAR

Sot, më datë _____.____.2023, u dorëzua te z./znj. _____, ose te personi i autorizuar me prokurë z./znj. _____.

Sasia e naftës e përfituar _____ litra

Sasia e naftës që tërhiqet:

1. Sasia _____ litra, brenda datës _____.____.2023.

1. Sasia _____ litra, brenda datës _____.____.2023

Sasia e naftës bëhet aktive brenda 7 (shtatë) ditësh nga dorëzimi.

Bashkëlidhur fotokopje e letërnjoftimit elektronik.

Prokurë përfaqësimi (nëse ka).

Dorëzues për “Posta Shqiptare” sh.a.

Marrësi në dorëzim
